

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA NURAJ KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 35703/17)

VENDIM
STRASBURG
10 tetor 2023

Ky vendim është i formës së prerë, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Nuraj kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 35703/17) kundër Republikës së Shqipërisë, depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), më 13 maj 2017, nga një shtetase shqiptare, znj. Hajrie Nuraj, lindur në vitin 1960 dhe banuese në Tiranë ("kërkuesja"), e cila u përfaqësua nga z. S. Puto, një avokat që e ushtron ligjin në Tiranë;

vendimin për të bërë me dije, në lidhje me ankesën bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës mbi të drejtën e kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës, Qeverinë Shqiptare ("Qeveria"), përfaqësuar nga Agjenti i saj, znj. B. Lilo, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të deklaruar pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 19 shtator 2023,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për shkelje të së drejtës së kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me refuzimin e gjykatave vendase për të shqyrtuar pretendimin e saj për punësim ndaj një ambasade të huaj në bazë të imunitetit shtetëror.

FAKTET

2. Në periudhën midis vitit 2012 dhe 2014, kërkuesja u punësua si sekretare pranë Ambasadës së Katarit në Tiranë. Sipas kontratës së punësimit, pozicioni i kërkueses përcaktohej si "sekretare" dhe "oficere administrative". Kontrata nuk përfshinte një përshkrim specifik të punës. Në praktikë, ajo punonte edhe si përkthyes për ambasadën.

3. Kontrata parashikonte se, nëse midis palëve lindte një mosmarrëveshje, ajo:

"do të referohej pranë autoritetit gjyqësor kompetent pa paragjykim ndaj privilegjeve dhe imuniteteve diplomatike të misionit."

4. Në muajin nëntor 2014, ambasada e ndërpreu punësimin e saj për shkak të shkeljes së konfidencialitetit dhe disiplinës. Kërkuesja depozitoi pranë gjykatave shqiptare një padi për ndërprerje të paligjshme.

I. PROCESET VENDASE

A. Pjesa e parë

5. Më 13 shkurt 2015, Gjykata e Rrethit Tiranë dha një vendim të ndërmjetëm me anë të së cilit rrëzonte kërkesën e papranueshmërisë së ambasadës mbështetur në imunitetin shtetëror dhe deklaronte se kishte juridiksionin për të gjykuar padinë. Gjykata theksoi se mosmarrëveshja nuk kishte të bënte me një padi publike (“*acta iure imperii*”), por me një padi private (“*iure acta gestionis*”), që nuk ishte e lidhur me sovranitetin e Shtetit. Gjykata shtoi se rrëzimi i juridiksionit do të shkaktonte shkeljen e së drejtës së kërkuësës për t’u drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

6. Ambasada e Katarit depozitoi një apelim pranë Gjykatës së Lartë duke argumentuar kryesisht se në mbështetje të Konventës së Vjenës 1961 për Marrëdhëniet Diplomatike (“Konventa e Vjenës”), imuniteti i saj do të duhej të ishte lënë në fuqi. Ambasada e Katarit shtoi gjithashtu se kontrata e punësimit nuk kishte asnjë parashikim në lidhje me autoritetin gjyqësor që ishte kompetent për të gjykuar padinë; për këtë arsye, kërkuësja i nënshtrohej detyrimit për të negociuar me ambasadën nëse padia do të shqyrtohej nga gjykatat shqiptare ose ato të Katarit.

7. Më 8 prill 2015, Gjykata e Lartë prishi vendimin e gjykatës më të ulët dhe vendosi se padia ishte e papranueshme për shkak të imunitetit Shtetëror. Gjykata konstatoi se në kontratën e punësimit, palët nuk kishin përcaktuar gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve. Në vijim, Gjykata e Lartë u mbështet në ligjin vendas dhe në Konventën e Vjenës për të arritur në përfundimin se nuk kishte arsye për të përjashtuar imunitetin e Shtetit të Huaj.

8. Pas apelimit kushtetues të kërkuësës, më 15 mars 2016, Gjykata Kushtetuese prishi vendimin e Gjykatës së Lartë dhe e riktheu çështjen për rigjykim pranë asaj gjykate. Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata e Lartë nuk kishte marrë në konsideratë zhvillimet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që përcaktonte një kufizim të imunitetit Shtetëror, në lidhje me mosmarrëveshjet e punësimit. Në të njëjtën linjë, Gjykata e Lartë nuk kishte përcaktuar nëse detyrimet specifike të kërkuësës në ambasadë përfshinin ushtrimin vetëm të detyrave administrative, apo kontribuonin në përmbushjen e objektivave sovranë të Shtetit të përfaqësuar. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese udhëzoi Gjykatën e Lartë t’i sqaronte këto çështje dhe të përcaktonte nëse ndonjë prej përjashtimeve të parashikuara në nenin 11 § 2 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Imunitetet Juridiksionale të Shteteve dhe Pasurive të Tyre 2004 (“Konventa e KB 2004”) do të ishte i zbatueshëm për çështjen konkrete.

9. Së fundmi, Gjykata Kushtetuese e udhëzoi Gjykatën e Lartë të adresonte pretendimin e Shtetit të huaj se kërkuësja kishte pasur akses në “një sërë dokumentesh konfidenciale” që i kishte përkthyer për ambasadën.

B. Pjesa e dytë

10. Në parashtrimet e saj vijuese pranë Gjykatës së Lartë, kërkuësja pohoi se kishte qenë vetëm një sekretare, dhe jo staf konsullor, dhe gjithçka që kishte përkthyer për ambasadën ishin artikuj nga shtypi shqiptar.

11. Më 29 qershor 2016, Gjykata e Lartë pranoi se ekzistonte një tendencë e përgjithshme sipas së cilës imuniteti i Shteteve kufizohej në lidhje me mosmarrëveshjet e punësimit, mbështetur në ilustrimet me anë të vendimeve të Gjykatës në çështjen *Cudak kundër Lituanisë* ([DHM], nr. 15869/02, §§ 54-59, GJEDNJ 2010) dhe *Sabeh El Leil kundër Francës* ([DHM], nr. 34869/05, §§ 46–54, 29 qershor 2011). Megjithatë, në mbështetje të nenit 39 të Kodit të Procedurës Civile (“KPC”) dhe nenit 31 § 1 dhe nenit 32 të Konventës së Vjenës (shih paragrafët 15–16 në vijim), Gjykata e Lartë konstatoi se pala mbrojtëse nuk kishte hequr dorë nga imuniteti i saj dhe gjykoi edhe një herë se padia ishte e papranueshme. Për sa i përket Konventës së KB 2004, që konsiderohet të zbatohet në Shqipëri si e drejtë ndërkombëtare zakonore, konstatohet se:

“19. [...] çështja konkrete trajtohet nga paragrafi i dytë i nenit 11 [të Konventës së KB 2004] pasi [...] kontrata e punësimit në shqyrtim është pjesë e sferës së masave të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbushjen e misionit ose funksionit diplomatik sipas Konventës së Vjenës, por edhe sipas interpretimit të Nenit 11/2/a/d [i] të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Imunitetet Juridiksionale të Shteteve dhe Pasurive të Tyre (përjashtimet).

20. [...] pasi pala paditëse ishte punësuar si përkthyes dhe sekretare e Ambasadorit të Shtetit të Katarit, aktiviteti i saj lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë me aktivitetin e përfaqësimit diplomatik të Shtetit të huaj,

për këtë arsye imuniteti sovran i Shtetit të huaj justifikon kufizimin e të drejtës së paditëses për t'iu drejtuar gjykatës.

21. Banka Civile e Gjykatës së Lartë mban në konsideratë edhe detyrat specifike të përmbushura nga pala paditëse. Duke iu referuar parashkrimeve të palëve, konstatohet se paditësja kishte akses në dokumente të caktuara që i përkthente dhe ia kalonte në mënyrë të drejtpërdrejtë përfaqësuesve të shtetit të Katarit, që do të thotë, ajo kishte akses në materiale konfidenciale sensitive që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me interesat sovranë të shtetit të Katarit. Nga ana tjetër, paditësja nuk parashtrroi në gjykatë se materialet e përkthyer prej saj nuk ishin konfidenciale.

22. Sipas rrethanave, detyrat e paditëses kishin të bënin me aspekte të konfidencialitetit... Aktiviteti i paditëses nuk mund të klasifikohet vetëm si aktivitet administrativ.”.

12. Gjithashtu, sipas kontratës së punësimit (shih paragrafin 3 më sipër), gjykata konstaton se: “pala e paditur nuk pati kurrë si synim të hiqte dorë nga privilegjet dhe imuniteti i saj ... Nga interpretimi i këtij parashikimi kontraktual, rezulton se palët nuk kishin pasur asnjëherë si synim që ta paraqisnin zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre pranë gjykatave shqiptare, pasi: i. mosmarrëveshja shkaktohej prej marrëdhënieve të punës; ii. pala e paditur është një subjekt që gëzon imunitet diplomatik...; iii. pala e paditur nuk ka hequr dorë nga imuniteti dhe në këtë mënyrë mosmarrëveshja mund të gjykohej nga gjykatat shqiptare.”.

13. Më 21 dhjetor 2016, Gjykata Kushtetuese me shumicë votash, pesë me tre, rrëzoi apelimin kushtetues si të papranueshëm, duke gjykuar se Gjykata e Lartë e kishte arsyetuar rregullisht vendimin e saj.

14. Dy gjyqtarë bashkëlidhën një opinion të përbashkët kundërshtues ku shpreheshin se gjykata duhej të kishte analizuar çështjen sipas këndvështrimit në lidhje me “të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës” dhe jo sipas këndvështrimit mbi “mungesën e provave”. Gjithashtu, ata shpreheshin se Gjykata e Lartë nuk kishte mbajtur në konsideratë mjaftueshëm praktikën gjyqësore të Gjykatës që orientohej drejt kufizimit të imunitetit shtetëror. Ata arrinin në përfundimin se sipas aspekteve *prima facie* të paraqitura, çështja do të duhej të ishte deklaruar e pranueshme.

II. LIGJI PÛRKATËS VENDAS

15. Neni 39 i KPP-së parashikon:

Neni 39

“Anëtarët e misionëve konsullorë dhe diplomatike në Republikën e Shqipërisë nuk janë subjekt i juridiksionit të gjykatave shqiptare, me përjashtim të rasteve kur:

- a) ata bien dakord vullnetarisht [me atë juridiksion];
- b) përmbushen kushtet dhe termat e parashikuar në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplommatike [për heqjen e imunitetit].”.

III. LIGJI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR

A. Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplommatike

16. Neni 31 § 1 dhe neni 32 i Konventës, që hyri në fuqi në Shqipëri më 8 shkurt 1998, parashikon:

Neni 31

“1. Një agjent diplomatik gëzon imunitet ndaj juridiksionit penal të Shtetit pritës. Ai gëzon imunitet edhe ndaj juridiksionit civil dhe administrativ...”

...

Neni 32

14. Imuniteti ndaj juridiksionit të agjentëve diplomatikë dhe personave që gëzojnë imunitet sipas nenit 37 mund të hiqet nga Shteti dërgues...”

B. Konventa e Kombeve të Bashkuara 2004 mbi Imunitetet Juridiksionale të Shteteve dhe Pasurive të Tyre

17. Në muajin dhjetor 2004, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Konventën mbi Imunitetet Juridiksionale të Shteteve dhe Pasurive të Tyre. Ajo u hap për nënshkrim më 17 janar 2005 dhe nuk ka hyrë ende në fuqi. Neni 11 i Konventës parashikon si më poshtë:

Neni 11

Kontratat e punësimit

“1. Përveç rasteve kur Shtetet në fjalë bien dakord midis tyre, një Shtet nuk mund të kërkojë imunitet nga juridiksioni pranë një gjykate të një Shteti tjetër që është kompetent në një proces që ka të bëjë me një kontratë punësimi midis Shtetit dhe një individi për punën e kryer ose që do të kryhet, plotësisht ose pjesërisht, në territorin e atij Shteti tjetër.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet nëse:

a) i punësuar është punësuar për të kryer funksione të caktuara në ushtrim të autoritetit qeveritar;

...
(d) lënda e procesit është pushimi ose ndërprerja e punësimit të një individi dhe, sipas përcaktimit nga kreu i Shtetit, kreu i qeverisë ose Ministri për Punët e Jashtme i Shtetit që ofron punësimin, një proces i tillë do të ndërhynte në interesat e sigurisë së atij Shteti;

...”

VLERËSIMI I GJYKATËS

PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

18. Në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, kërkesja pretendonte se ajo ishte privuar nga e drejta e saj për t’iu drejtuar gjykatës, për sa i përket imunitetit juridiksional të kërkuar nga punëdhënësi i saj dhe lënë në fuqi nga gjykatat vendase.

A. Pranueshmëria

19. Në mbështetje të nenit 1 të Konventës, Qeveria parashitroi se kërkesja nuk kishte qenë “brenda juridiksionit” të Shqipërisë, sepse ajo kishte rënë dakord se mosmarrëveshjet me punëdhënësin e saj do të zgjidheshin nga gjykatat e Katarit, në këtë mënyrë, duke përjashtuar juridiksionin e gjykatave shqiptare dhe, për pasojë, juridiksionin e Gjykatës. Kërkesja e kundërshtoi atë pohim.

20. Edhe pse Gjykata e Lartë vendosi se i mungonte juridiksioni për të gjykuar themelin e padisë së kërkuar, për të arritur në këtë gjykim, ajo ushtroi pushtetin e saj për të marrë një vendim mbi çështjen e paraqitur pranë saj nga kërkesja. Në vijim, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi dhe rrëzoi apelimin kushtetues të kërkuar. Rezulton se për sa ka të bëjë me pajtueshmërinë e vendimeve vendase me nenin 6 § 1 të Konventës, kërkesja ishte “brenda juridiksionit” të Shqipërisë për qëllimet e nenit 1 të Konventës (krahaso me *Naku kundër Lituanisë dhe Suedisë*, nr. 26126/07, §§ 78–79 dhe 95, 8 nëntor 2016).

21. Për sa argumenti i Qeverisë mund të kuptohet edhe si një kërkesë se kërkesja kishte hequr dorë nga e drejta e saj sipas nenit 6 § 1 të Konventës për të përfutur të drejtën t’i drejtohej gjykatave shqiptare, Gjykata gjykon se ky kundërshtim duhet t’i bashkohet themelit të ankesës.

22. Kjo ankesë nuk është e pambështetur haptazi në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës, apo e papranueshme për shkaqe të tjerë. Për këtë arsye duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

1. Parimet e përgjithshme

23. Parimet përkatëse të përgjithshme për të drejtën për t’iu drejtuar një gjykate të garantuara nga neni 6 § 1 i Konventës përcaktohen në *Cudak kundër Lituanisë* ([DHM], nr. 15869/02, §§ 54–59, GJEDNJ 2010) dhe *Sabeh El Leil kundër Francës* ([DHM], nr. 34869/05, §§ 46–54, 29 qershor 2011).

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Nëse kërkesja hoqi dorë nga e drejta e saj

24. Gjykata vëren se pala e paditur parashitroi pranë gjykatave vendase se palët nuk kishin rënë dakord se për cilin juridiksion do të shqyrtonin mosmarrëveshjen dhe kjo çështje kërkonte

negocime të mëtejshme (shih paragrafin 6 më sipër). Ky argument vë në dyshim sugjerimin e Qeverisë se kërkuesja kishte hequr dorë nga e drejta e saj për t'iu drejtuar gjykatave shqiptare.

25. Gjithashtu, Gjykata e Lartë pohoi se palët nuk kishin pasur si synim të paraqisnin mosmarrëveshjen e tyre pranë gjykatave shqiptare (shih paragrafin 12 më sipër). Megjithatë, nuk rezultoi se ky përfundim mbështetej në analizën nëse kërkuesja në mënyrë të lirë dhe pa mëdyshje kishte zgjedhur të hiqte dorë nga e drejta e saj për t'iu drejtuar një gjykate (shih, *mutatis mutandis*, Suda kundër Republikës Çeke, nr. 1643/06, § 48, 28 tetor 2010). Ky vendim mbështetej më së shumti në konstatimin e mëparshëm të Gjykatës së Lartë se pala e paditur nuk kishte hequr dorë nga imuniteti i saj. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se pika kryesore e mosmarrëveshjes pranë gjykatave vendase ishte nëse pala e paditur gëzonte imunitet, dhe jo nëse kërkuesja kishte hequr dorë nga e drejta e saj për t'iu drejtuar gjykatave shqiptare. Në të vërtetë, gjatë gjithë proceseve, gjykatat vendase proceduan duke prezumuar se e drejta e kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës ishte në rrezik. Ato u mbështetën në praktikën gjyqësore sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe u përpoqën të balanconin të drejtat e kërkueses me të drejtën e palës së paditur për imunitet.

26. Për sa më sipër, Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e Qeverisë se kërkuesja kishte hequr dorë nga e drejta e saj për t'iu drejtuar një gjykate, në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës.

b) Nëse është shkelur e drejta e kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës

27. Akordimi i imunitetit ndaj një Shteti ndjek një qëllim legjitim (shih *Cudak*, cituar më sipër, § 60). Për këtë arsye, thelbi i çështjes pranë Gjykatës është nëse kufizimi i kundërshtuar ndaj së drejtës së kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës ishte proporcional.

28. Gjykata vëren se Shqipëria nuk ka ratifikuar Konventën e KB 2004, por as nuk ka votuar kundër miratimit të saj, dhe gjykatat vendase i janë referuar shprehimisht kësaj konvente (shih paragrafët 8 dhe 11 më sipër). Për këtë arsye, për Shqipërinë, Konventa e KB 2004 zbatohet sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare (shih *Cudak*, cituar më sipër, § 66–67).

29. Neni 11 i Konventës së KB 2004 parashikon rregullin se një Shtet nuk ka imunitet juridiksional për kontratat e punësimit, me përjashtim të situatave që përcaktohen në mënyrë shteruese në të. Kërkuesja u shpreh se çështja e saj nuk përkonte me ndonjë nga përjashtimet në fjalë, por gjykatat vendase gjykan për të kundërtën.

30. Si një vërejtje paraprake, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë nuk sqaronte se nënparagrafi specifik i nenit 11 § 2 të Konventës së KB 2004 zbatohet për kërkuesen (shih paragrafin 11 më lartë). Vendimi i Gjykatës së Lartë i referohej “nenit 11/2/a/d”. Megjithatë, duke qenë se dispozita në fjalë nuk përmban një paragraf “a/d”, kjo referencë duhet të konsiderohet se i referohet dy nënparagrafëve të ndryshëm, më konkretisht “a” dhe “d” të dispozitës në fjalë. Sidoqoftë, është e vështirë të pranohet se çështja e kërkueses përkon me ndonjë prej këtyre paragrafëve.

31. Fillimisht, nuk ka asnjë indicje se kërkuesja është punësuar “për të realizuar funksione të caktuara në ushtrim të autoritetit qeveritar” sipas nenit 11 § 2 (a) të Konventës së KB 2004. Në të vërtetë, kontrata e punësimit e kërkueses nuk përmbante asnjë përkthim pune të detajuar, gjë që vështirë se është e pajtueshme me një pozicion që ushtron autoritet qeveritar. Ajo ishte rekrutuar për të punuar si “oficere administrative” dhe/ose “sekretare” për Ambasadorin, funksion që, në mungesë të ndonjë shpjegimi tjetër, nuk mund të barazohet me ushtrimin e autoritetit qeveritar të Shtetit në fjalë.

32. Në lidhje me aktivitetin e saj të përkthimit, Gjykata thekson edhe një herë se kjo detyrë nuk përmendej aspak në kontratën e saj të punësimit, gjë që nënkupton se ky ishte një aktivitet dytësor përveç detyrave të saj si sekretare. Gjithashtu, për sa ka të bëjë me konstatimin e Gjykatës së Lartë se kërkuesja nuk kishte parashtruar përpara kësaj gjykate se materialet e përkthyer prej saj nuk ishin konfidenciale (shih paragrafin 11 më sipër), Gjykata i referohet memorandumit të kërkueses pranë asaj gjykate (shih paragrafin 10 më sipër) dhe thekson se ajo parashtroi se ajo kishte përkthyer artikuj të shtypit të shkruar, të cilët me natyrën që kanë nuk janë konfidencialë. Për Gjykatën nuk është e qartë se çfarë elementesh e çuan Gjykatën e Lartë në përfundimin se kërkuesja kishte pasur akses në informacione konfidenciale ose sensitive. Në çdo rast, një akses i

caktuar ndaj informacioneve sensitive që mund të jetë rasti për një person në cilësinë e sekretares së një ambasadori – nuk mund të barazohet me përmbushjen e funksioneve të caktuara në ushtrimin e autoritetit qeveritar sipas interpretimit të nenit 11 § 2 (a) të Konventës së KB 2004.

33. Duke u rikthyer në nënparagrafin “d” të nenit 11 § 2 të Konventës së KB 2004, në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk ka asnjë referencë të ndonjë përcaktim i bërë nga “kreu i Shtetit, kreu i Qeverisë apo Ministri i Punëve të Jashtme”, apo të ndonjë rrezik potencial që kërcënon interesin e sigurisë së Katarit. Pretendimi i thjeshtë se kërkuesja mund të ketë pasur akses në dokumente të caktuar ose mund të ketë pasur informacion për materiale konfidenciale gjatë detyrave të saj nuk është mjaftueshëm të çojë në një përfundim tjetër (shih *Cudak*, cituar më sipër, § 72). Rezulton se nuk është përcaktuar as se nënparagrafi ishte i zbatueshëm për çështjen.

34. Gjykata ka arritur në një përfundim të ngjashëm në çështje të ngjashme ku një kërkues ishte punësuar si oficer kulture, informacioni dhe shtypi (shih *Naku*, cituar më sipër, §§ 15 dhe 95), specialist protokolli, përkthyes dhe roje sigurie (*Radunović dhe të Tjerë kundër Malit të Zi*, nr. 45197/13 dhe 2 të tjerë, §§ 6 dhe 79, 25 tetor 2016), llogaritar (shih *Sabeh El Leil*, cituar më sipër, §§ 7 dhe 67) dhe operator centrali (*Cudak*, cituar më sipër, §§ 10 dhe 74).

35. Siç është theksuar me të drejtë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj të parë (shih paragrafin 8 më sipër), gjykatat vendase do të duhej të kishin shqyrtuar në thelb pikërisht fushën e veprimit të detyrave të kërkueses në mënyrë që t’iu përgjigjur pyetjes nëse ndonjë prej nënparagrafëve të nenit 11 §2 të Konventës së KB 2004 ishte i zbatueshëm për çështjen. Ky shqyrtim specifik për faktet nuk pritej të realizohej, dhe në vend të tij, gjykatat vendase u mbështetën kryesisht në faktin se kërkuesja ishte e punësuar në një ambasadë të huaj dhe kishte pasur akses në materiale të papërcaktuara që supozoheshin të ishin sensitive. Edhe pse ky aspekt u theksua nga gjyqtarët kundërshtues, ai nuk u zgjidh as në vendimin e dytë të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 13–14 më sipër).

36. Për këtë arsye, është shkëlur neni 6 § 1 i Konventës.

NENI 41 I KONVENTËS

37. Kërkuesja kërkoi 40,200 euro (EUR) për dëmin pasuror dhe jo pasuror, respektivisht. Gjithashtu, ajo kërkoi 3,640 euro për kostot dhe shpenzimet bërë në Gjykatë, duke i mbështetur me një faturë proforma me zërat përkatës dhe nuk depozitoi asnjë kërkesë për këtë kategori për proceset vendase.

38. Qeveria i konsideroi shumat të tepërta dhe të pambështetura me anë të faturave të miratuara në mënyrë zyrtare.

39. Gjykata ka konstatuar një shkelje të së drejtës së kërkueses për t’iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe nuk dha asnjë gjykim për ligjshmërinë e shkarkimit të saj. Në këtë mënyrë, i takon kërkueses të kërkojë që të rihapen proceset vendase. Pasi nuk ka asnjë lidhje shkakore midis shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe dëmit pasuror të pretenduar, Gjykata e rrëzon këtë kërkesë.

40. Në lidhje me dëmin jo pasuror, Gjykata akordon 3,600 euro nën këtë kategori plus çdo taksë që mund t’i tarifohet kërkueses.

41. Duke u rikthyer te kostot dhe shpenzimet, siç ka bërë edhe në të shkuarën (shih *Hysa kundër Shqipërisë*, nr. 52048/16, § 93, 21 shkurt 2023, me referenca të tjera), Gjykata e rrëzon argumentin e Qeverisë sipas së cilit kërkohet që kostot dhe shpenzimet duhet të mbështeten me anë të faturave të miratuara zyrtarisht. Duke marrë në konsideratë justifikimet e parashtruara nga kërkuesja, Gjykata e gjykon të arsyeshme t’i akordojë kërkueses shumën e kërkuar prej 3,640 euro, që mbulon kostot dhe shpenzimet në Gjykatë, plus çdo taksë që mund t’i tarifohet kërkueses.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *Rrëzon* kundërshtimin paraprak të Qeverisë për mungesë juridiksioni;
2. *Bashkon* në themel kundërshtimin në lidhje me pretendimin për heqje dorë nga e drejta e kërkueses për t’iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe *e kundërshton* atë;

3. *E deklaron* kërkesën të pranueshme;

4. *Gjykon* se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës;

5. *Gjykon*

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkueses, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

i. 3,600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme, për dëmin jopasuror;

ii. 3,640 euro (tre mijë e gjashtëqind e dyzet euro) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për kërkuesen për kostot dhe shpenzimet;

b) se që nga përfundimi i periudhës tremujore të sipërpërmendur deri në shlyerje, duhet të paguhet interes i thjeshtë për shumat e mësipërme në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre pikë përqindje.

6. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkueses për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 10 tetor 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Georgios A. Serghides
KRYETAR